



Localgap standard për prodhimet shqiptare që mund të prodhohen dhe tregtohen në tregun vendas kundrejt një label-i të mirënjohur

Faqe 6



"Malasi Olive Oil", vaji i certifikuar i ullirit gjen tregje në Europë e në SHBA

Faqe 7



KASH pjesë e takimit bashkë-krijues për projektin "Bashkëpunimi me Sipërmarrjen dhe Zgjidhjet për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm"

Faqe 2



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KESHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit mars 2023

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 457
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

MINISTRIA E BUJQËSISË, PËRCAKTON KRITERET PËR SEKTORËT QË MBËSHTETEN TË GJITHË BUJQIT, BLEGTORËT DHE PESHKATARËT, DO TË KENË NË DISPOZICION MILIONA LEKË PËR TË PËRFITUAR MBËSHTETJE NGA MASAT E FINANCIMIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR 2023

Përfitues për masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë fermerët, personat fizikë, personat juridikë, Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB), grupet vendore të veprimit (GVV) dhe UBT-ja. Kriteret, procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen me udhëzim të përbashkët të MBUZHR dhe MFE

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Zvicra dhe Shqipëria nënshkruajnë marrëveshje për projektin mbi tregun e punës për të rinjtë

Formalizohet bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ambasadës së Zvicrës për zbatimin e projektit për tregun e punës për të rinjtë - RisiAlbania



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



FONDI I GARANCISE SOVRANE

Kreditimi i bujqësisë, 100 milionë euro disbursim nga garancia me BERZH

Faqe 4

KËNDI I EKSPERTIT

- Këshilla për fermerët mbi shërbimet në kulturat drufrutore Fq.11
- Këshilla për fermerët kultivues të bimës së misrit Fq.11
- Këshilla mbi shërbimet e stinës në frutikulturë Fq.12
- Informacion për fermerët që kultivojnë bimë aromatike medicinale (BAM) Fq.12
- Shpërbërja e plastikës - një problem i madh mjedisor Fq.13

Krifca: Matrikullimi i kafshëve, mundësi për subvencione për blegtorët

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca i ka bërë thirrje blegtorëve që të bëjnë matrikullimin e kafshëve në ferma, ku thirrja do të hapet së shpejti për këtë proces...



Faqe 4

SIPERMARRJE BUJQËSORE

Krifca: Mbështetëm 137 gra sipërmarrëse në bujqësi me 24 milionë euro



Faqe 6

KUALIFIKIM KARIERE

6 ofrues të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) marrin vulën e Akreditimit

Faqe 2

RISI ALBANIA

Zvicra dhe Shqipëria nënshkruajnë marrëveshje për projektin mbi tregun e punës për të rinjtë

Formalizohet bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ambasadës së Zvicrës për zbatimin e projektit për tregun e punës për të rinjtë - RisiAlbania

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë Delina Ibrahimaj së bashku me Ambasadorin zviceranë Ruth Huber nënshkruan marrëveshjen për zbatimin e fazës së tretë të projektit RisiAlbania – për një treg pune funksional për rininë.

medicinale, frutat dhe perimet, që i japin mundësi bizneseve të aksesojnë tregje me vlerë të lartë, të rrisin të ardhurat në vend dhe të krijojnë më shumë mundësi punësimi për të rinjtë”, tha Ministrja.

“Është me rëndësi të mad-

autoriteteve të Shqipërisë ku rolin qendror e ka Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për të përmirësuar këshillimin dhe mirëinformimin e të rinjve mbi karrierën, rritjen e aftësive që kërkon tregu, si dhe mbështetje që bizneset të mund të jenë më konkurrues dhe të qëndrueshëm. Projekti është në fazën e tretë dhe të fundit dhe granti nga qeveria e Zvicrës është 6.9 milion Euros.

Projekti orientohet drejt inovacionit dhe punon në fushat e agrobiznesit, teknologjisë së informacionit dhe turizmit. Në dy fazat e mëparshme ka prezantuar praktika të reja dhe të vlefshme të cilat do synojë t'i shtrijë edhe më tej dhe të konsolidojë një mjedis më të favorshëm për punësimin e të rinjve. Kontributi i projektit në dy fazat e mëparshme përfshin: mundësimin e punësimit për rreth 12,000 të reja e të rinj, përmirësimin e informacionit për punësimin për rreth 110,000 të reja/të rinj, si dhe rritjen e aftësive dhe formimit për 9,750 të reja/të rinj.

Fokus të veçantë do të ketë në fushën e standardeve të cilësisë ku sektori privat do të mbështetet me përshtatjen ndaj standardeve ndërkombëtare dhe të BE-së.



Ministrja Ibrahimaj theksoi se në fokus të politikave tona janë projektet dhe programet që synojnë të sjellin rritjen e punësimit, qoftë ato me financim të drejtpërdrejtë, qoftë ato që synojnë të nxisin proceset njohëse, veçanërisht të digjitalizimit.

“Politikat buxhetore që po ndërmarrim synojnë edhe nxitjen e sektorëve, si turizmi, bujqësia përmes zhvillimit të zinxhirit të vlerës në bimët

he pajisja e të rejave dhe të rinjve me këshillimin e duhur për karrierën dhe me aftësi të cilat vlejnë në treg. Është po me kaq rëndësi edhe aftësimi i bizneseve për të ofruar punë më të mira dhe më të shumta. Ky është objektivi i projekt-marrëveshjes që nënshkruajmë sot”, tha Ambasadorja zvicerane Ruth Huber.

Marrëveshja formalizon dhe lehtëson bashkëpunimin midis disa institucioneve dhe

6 ofrues të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) marrin vulën e Akreditimit

Swiss Development & Cooperation dhe PNUD kanë mbështetur Agjencinë Kombëtare të AFP-së dhe Kualifikimeve për të zhvilluar një model Akreditimi

6 ofrues publik dhe një ofrues privat të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) morën vulën e Akreditimit, gjatë një ceremonie të organizuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe UNDP, me pjesëmarrjen e Swiss Development & Cooperation, aktorëve kryesorë të sektorit dhe shkollave të AFP-së.

Përmes projektit të Zhvillimit të Aftësive për Punësim SD4E, financiar nga Embassy of Switzerland in Albania, UNDP ka mbështetur zhvillimin e kornizës së sigurimit të cilësisë në AFP. Pas zhvillimit të modelit të akreditimit, procedurave, kritereve dhe standardeve dhe zhvillimit të kapaciteteve të stafit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe 52 vlerësuesve të jashtëm, 6 ofrues të AFP-së përfunduan me sukses procesin e akreditimit dhe morën dritën e gjelbër për certifikim.

Akreditimi është një moment i rëndësishëm në zhvillimin e sistemit shqiptar të AFP-së. Besimi në kualifikimet e ofruara nga institucionet e AFP-së, luan një rol vendimtar për njerëzit

min, punësimin dhe integrimin socio-ekonomik të të rinjve, të cilët kanë mangësi në përfshirjen në punësim, arsim apo formim profesional, përmes shërbimeve për zhvillimin e



dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. UNDP do të vazhdojë të mbështesë institucionet shqiptare për të çuar përpara reformën e sistemit të AFP-së.

Projekti synon promovim,

aftësive për jetën, shkathhtësive dhe vetë-fuqizimit.

Problemet kryesore që hasen në lidhje me edukimin dhe

(Vijon në faqen 4)

KASH - DONATORËT

KASH pjesë e takimit bashkë-krijues për projektin “Bashkëpunimi me Sipërmarrjen dhe Zgjidhjet për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm”

Kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar Agim Rrapaj dhe përfaqësues të institucioneve të linjës, të biznesit dhe shoqërisë civile diskutuan në një takim me donatorët për zgjerimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e hapave të mëtejshëm të zbatimit të projektit për muajt në vijim që ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi SDG-të dhe praktikatat e qëndrueshme për sipërmarrjet shqiptare që operojnë në sektorin e agropërpunimit dhe tekstileve.

Së bashku me United Nations Albania dhe Embassy of Sweden in Tirana organizuam një takim bashkë-krijues në kuadër të projektit “Bashkëpunimi me Sipërmarrjen dhe Zgjidhjet për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm”.

Në takim morën pjesë Petra Burcher, përfaqësuese e Ambasadës Suedeze, Fiona McCluney, Koordinatorë e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe Monica Merino, Përfaqësuese e Përhershme e PNUD në Shqipëri.

Në këtë diskutim rreth zhvillimit të projektit morën pjesë edhe përfaqësues nga Ministria e Finan-

për sipërmarrjet shqiptare që operojnë në sektorin e agropërpunimit dhe tekstileve.



cave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes si dhe ekspertë vendas e ndërkombëtarë dhe përfaqësues nga kompani dhe shoqata sektoriale, me qëllim përcaktimin e hapave të mëtejshëm të zbatimit të projektit për muajt në vijim.

Objektivi i projektit është të rrisë ndërgjegjësimit mbi SDG-të dhe praktikatat e qëndrueshme

Presim me padurim Konferencën Business 2030 që do të zhvillohet në Tiranë në muajt maj/qershor 2023, me pjesëmarrjen e kompanive vendase, atyre suedeze dhe ndërkombëtare.

Projekti “Bashkëpunimi me Sipërmarrjen dhe zgjidhjet për SDG-të” financohet nga Qeveria e Suedisë dhe zbatohet nga agjencitë UNDP, FAO, ILO dhe UNIDO.

Skema Kombëtare, Krifca: Garantojmë mbështetjen e fermerëve dhe të bujqësisë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në një përmbledhje të punëve të kryera



javën që po mbyllet, theksoi se, në fokus kryesor ishte, miratimi nga qeveria i dokumentit të politikës për mbështetjen e drejtpërdrejtë të fermerëve gjatë vitit 2023.

“Skema Kombëtare e Mbështetjes së Bujqësisë me 3,3 miliardë lekë mbështet drejtpërdrejtë blegtorët, bletarët, prodhuesit në serra të perimeve, luleshtrydheve dhe rrushit të tavolinës, fermat organike dhe ato që certifikohen me standardin GlobalGAP, si dhe peshkatarët për rinovimin e flotës”, u shpreh ministrja Krifca.

Gjithashtu theksoi ajo, MB-ZHR do të vijojë politikën për zgjerimin e tregjeve për fermerët e vegjël duke mbështetur financiarisht bashkitë.

“Zgjerimë kështu ak-

sesin në tregje duke iu dhënë mundësinë fermerëve të fuqizohen përmes bashkëpunimit dhe të rrisin vlerën e prodhimeve të tyre. Do të mbështesim financiarisht ndërtimin e tregjeve të reja bujqësore dhe të kafshëve të gjalla, përfshirë edhe thertoret, duke u kujdesur veçanërisht për ato bashki që kanë aktualisht mungesa të kësaj natyre”, theksoi Krifca, teksa informoi se, “kjo është një politikë që prek direkt fermerët e vegjël duke i dhënë atyre mundësinë të jenë më konkurrues, më afër me nevojat e konsumatorëve”.

Ministrja tha se, do të vijoi gjithashtu mbështetja për Skemën e Trajnimit të Bujqësisë, për krijimin e fermave model me teknologji e standarde bashkëkohore.

“Jemi kujdesur përmes kësaj skeme të ruajmë stabilitet të skemës, ta kompletim mbi programin IPARD të cilin jemi duke e zbatuar. Kjo, edhe për të garantuar tek fermerët që politikën në bujqësi nuk janë sporadike që ndryshojnë vit pas viti, por ato janë të vazhdueshme, të ndërtuara për fermerët pas një analize të thellë të sektorit. Po ashtu, mbështetja jonë synon që fermat të zmadhohen dhe konsolidohen apo fermerët të bashkohen dhe të rrisin prodhimin dhe ofertën tyre në këtë mënyrë

duke zgjeruar edhe aksesin në tregje”, deklaroi Krifca.

Ministrja veçoi se një lajm shumë i rëndësishëm mbi financimin në bujqësi gjatë kësaj jave ishte edhe mbyllja e negociatave që MBZHR bëri me Bankën Botërore, për një projekt të ri të cilin kemi muaj e muaj me të cilin kemi kujdesur për ta ndërtuar me shumë kujdes, përse i takon zhvillimit të bujqësisë të qëndrueshme ndaj klimës.

“Mundësojmë një mbështetje të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, për përmirësimin e standardizimit e sigurisë ushqimore, për modernizimin e sistemit të ujitje-kullimit, si dhe rritjen e aksesit në tregje”, tha ajo.

Krifca solli në vëmendje dhe mbledhjen e përbashkët që u zhvillua në Podgoricë, mes qeverisë shqiptare dhe asaj të Malit të Zi për zgjerimin e tregjeve rajonale, ku u firmosën edhe dy marrëveshje të rëndësishme në fushën e bujqësisë.

“Bashkëpunimin në Fushën e Mbrojtjes së Bimëve”, dhe “Menaxhimi i Përbashkët i Qëndrueshëm i Peshkimit në Liqenin e Shkodrës dhe në Lumin Buna”, janë dy marrëveshje që nxisin më tej ndërveprimin mes dy vendeve në sektorin e bujqësisë”, u shpreh Krifca.

IPARD II, 326 kontrata investimesh të përfunduara me sukses

Drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Eranda Selmanaj zhvilloi një takim me fermerët përfutues të programit IPARD II të cilët janë ende në proces të realizimit të investimit të tyre.

AZHBR informoi se, “qëllimi i këtij takimi ishte bashkëbisedimi për evidentimin e të gjitha problematikave dhe rrugëzgjdhjeve për të realizuar mbylljen e investimeve brenda afateve të përcaktuara në kontratë”.

Fermerët përmes një diskutimi të hapur patën mundësi të flisnin mbi vështirësitë që kanë hasur në punën e tyre dhe shtruan të gjitha pyetjet e nevojshme mbi procedurat në vazhdim.

AZHBR në kuadër të programit IPARD II ka në proces 164 kontrata për investime të



cilat pritet të mbylljen së shpejti, ndërsa 326 kontrata janë investime të përfunduara me sukses.

“Tashmë jemi edhe në pritje të programit IPARD III, i cili ofron një vlerë më të lartë sub-

vencioni në ndihmë të zhvillimit të bujqësisë në vend”, thuhet në njoftimin e AZHBR-së.

Kreditimi i bujqësisë, 100 milionë euro disbursim nga garancia me BERZH

Transformimi i bujqësisë, nga një sektor prodhues për nevojat lokale, në një sektor

eron rreth 19% të PBB dhe burim kryesor punësimi ku është e angazhuar 37% e popullsisë,

financim e që do të ndihmonte në zbutjen e rreziqeve mund të ishte edhe aplikimi i produkteve të sigurimit të fermerëve.

“Gjithashtu ne aktualisht kemi arritur në një normë disbursimi të fondit të garancisë me BERZH në pothuajse 100 mln euro, por mbeten ende fonde në dispozicion, të cilat nëse nuk përdoren nga bankat, duhet të përdoret nga institucionet e mikrofinancës”, u shpreh Krifca.

Fondet e garancisë përfaqësojnë një instrument inovativ financiar për të inkurajuar kreditimin nga institucionet financiare në të gjithë zinxhirin e vlerës së agrobiznesit dhe në sektorin e turizmit.

Përfutuesit janë fermerët, sipërmarrësit dhe kompanitë që janë të angazhuar në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore, prodhimin dhe tregtinë e pajisjeve bujqësore, logjistikën, ofruesit e shërbimeve të agrobiznesit, tregtarët me shumicë dhe pakicë.

Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, institucionet e mikrofinancës, fermer dhe agropërpunues nga zona të ndryshme të vendit.



modern të orientuar drejt komercializimit dhe konkurrueshmërisë së tregut ndërkombëtar, mbetet ende sfida për Shqipërinë, por në këtë drejtim ka disa nisma pozitive që kanë rritur aksesin e fermerëve.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca diskutoi me institucionet e mikrofinancës për rritjen e aksesit në financim të fermerëve dhe kreditimin e bujqësisë, ku vuri në dukje se, bujqësia është një sektor i rëndësishëm në ekonominë e vendit që gjen-

por kreditimi i bujqësisë nga sektori bankar mbetet në nivele të ulëta.

Krifca tha se, “qeveria ka aplikuar disa skema për mbështetjen financiare të sektorit të bujqësisë si, Skema Kombëtare, programi IPARD si dhe mekanizmat e skemës së fondit të garancisë, të cilat janë zgjidhje për zbutjen e rreziqeve të kreditimit të bujqësisë dhe mbështesin zhvillimin e sektorit”.

Sipas saj, mekanizëm tjetër që ndihmon rritjen e aksesit në

6 ofrues të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) marrin vulën e Akreditimit

(Vijon nga faqja 2)

zhvillimin e aftësive profesionale në Shqipëri, vijnë nga faktorë të ndryshme, ndër to:

1. Aftësitë e fituara përmes trajnimeve profesionale nuk korrespondojnë me ato që kërkohen nga tregu i punës, duke rezultuar në një mungesë të aftësive profesionale në disa sektorë dhe teprica në të tjerë.

midis aktoreve publikë dhe privatë (ministritë, agjencitë, autoritetet lokale, partnerët socialë, OJQ-të, etj) të kufizuara në aftësi dhe instrumenta të nevojshme në menaxhim dhe programim të situatës.

3. Qasja e dobët në informacion përsa i përket tregut të punës: informacioni i besueshëm dhe i përditësuar mbi tregun e punës nuk është i garantuar, pavarësisht ristrukturimit të

fundit të rritjes të shërbimeve të punësimit në të gjithë territorin kombëtar.

4. Mungesa e mundësive të punësimit për të rinjtë në zonat rurale nënkupton humbjen e produktivitetit dhe rritjen e ekspozimit ndaj punës informale, (për të mbështetur ekonominë e familjes), si dhe në zonat urbane (ku ata janë të punësuar në mënyrë informale në sektorin shërbimeve).

Rama: Vijon ringritja e sistemit kullues të tokave bujqësore në Fier

Një nga investimet e rëndësishme të qeverisë në mbështetje të bujqësisë është edhe garantimi i ujitjes së tokave bujqësore, që ka dyfishuar sipërfaqen e tokës së punueshme në Shqipëri, duke e çuar atë nga 120 mijë ha, në 240 mijë ha.

Kryeministri Edi Rama ndau në rrjetet sociale momente nga puna e përditshme që kryhet në mbështetje të fermerëve në fshatin Kallm i Madh në Fier, për rehabilitimin e sistemit kullues.

Ndërsa ndau pamje nga tokat e mbjella, Rama tha se po vijon puna edhe në shumë fshatra të tjerë të zonës.

Rehabilitimi i sistemit të kullimit dhe vaditjes konsiderohet si investimi më i mirë që po i bëhet ripërtëritjes së bujqësisë dhe ekonomisë së vendit.

Në këtë drejtim, ndërhyrje rrënjësore për sistemin e kanaleve kulluese e vaditëse si dhe te kolektorët kryesorë po bëhet në gjithë fushën e Myzeqesë.

Rindërtimi i sistemit kullues të tokave ka lehtësuar situatën e përmbytjeve, por edhe ka rritur produktivitetin e tokave bujqësore.

Ringritja e sistemit të kullimit të tokave bujqësore ga-

ranton që fermerët e fushës së Myzeqesë të mos kenë më probleme përmbytjes të tokave bujqësore prej reshjeve që bien në stinën e dimrit.

Po ashtu, hapja e rrugëve të parcelave është një tjetër element që ecën paralel me sistemin e kullimit dhe vaditjes, në shërbim të fermerëve, prodhimin bujqësor dhe lehtësisë sipërmarrëse.

Me ndarjen e re territoriale rreth 50% e gjithë territorit të bashkisë Fier është zonë rurale dhe pothuajse tërësisht është zonë bujqësore dhe me tokë shumë pjellore.

Krifca me Komitetin Drejtues të Fondit të Garancisë: Krijoni kontakte të drejtpërdrejta me fermerët

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural po synon rritjen e aksesit në financimin e fermerëve dhe agrobiznesit përmes diversifikimit të instru-

villim për financimin e bujqësisë dhe agrobiznesit, që u zhvillua në mjediset e kësaj ministrie.

“Më erdhi mirë të konstatoj ecurinë pozitive me një hov

dia me probleme për sektorin e bujqësisë, gjë e cila, siç tha ministrja, i atribuohet sektorit bujqësor e agropërpunues të shëndetshëm dhe në zhvillim.

“Është mjaft pozitive që NPL e kredive të këtij instrumenti është sa gjysma e mesatares, çka flet për një portofol dhe sektor bujqësor e agropërpunues të shëndetshëm”, tha Krifca.

Ministrja i kërkoi anëtarëve të komitetit që të lehtësojnë më tej kushtet dhe të krijojnë kontakte të drejtpërdrejta me fermerët për t'i orientuar më qartë e për të financuar më shpejt nevojat e tyre.

“Sfida jonë e përbashkët mbetet konsolidimi i bujqësisë shqiptare në një sektor modern të orientuar drejt tregut dhe konkurrues së tregut ndërkombëtar”, deklaroi ministrja.

Krifca shprehu angazhimin dhe gatishmëri për të arritur këtë, teksa vuri në dukje nevojën për të bashkëpunuar më ngushtë dhe për akses të shtuar në financime.



menteve financiare.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca mori pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të Fondit të Garancisë, të vënë në dispozicion nga qeveria shqiptare dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zh-

të ri realizimi gjatë vitit 2022 duke e çuar disbursimin e kredisë së garantuar për humbjet prej këtij instrumenti deri më tani në 100 milionë euro”, u shpreh Krifca.

Ministrja vuri në dukje faktin e nivelit të ulët që shënoi kre-

Matrikullimi i kafshëve, mundësi për subvencione për blegtorët

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca i ka bërë thirrje blegtorëve që të bëjnë matrikullimin e kafshëve në ferma, ku thirrja do të hapet së shpejti për këtë proces.

Krifca bën të ditur se, “matrikullimi i kafshëve në fermë është detyrim ligjor për çdo mbarështues, një proces ky që kryhet falas dhe jep mundësinë që blegtorët të përfitojnë shërbime falas nga Shërbimi Veterinar dhe subvencione nga shteti nëpërmjet Skemës Kombëtare të Mbështetjes”.

Ministrja tha se identifikimi individual i kafshëve dhe regjistrimi i fermave në regjistrin blegtoral nga veterinerët e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve

është hapi i parë i formalizimit të sektorit blegtoral, i cili siguron gjurmueshmërinë e shëndetit të kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore.

Krifca bëri të ditur se, “numri i matrikulluar sipas specieve është 4613 krerë gjedhë, të imëta 20194 krerë dhe të imëta për therje 14276 krerë”.



SIPËRMARRËSE NË BUJQËSI

MBZHR mbështet 137 gra sipërmarrëse në bujqësi me 24 milionë euro

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca në përmbledhjen e punëve të javës, theksoi se “nga ana e qeverisë, por edhe me programet e mbështetjes, i kemi mbështetur vazhdimisht gratë rurale, duke iu dhënë atyre prioritet”.

“Në programin IPARD II, ne kemi mbështetur mbi 137 gra fermere me një buxhet prej 24 milionë euro, gra sipërmarrëse që kanë ndër-tuar serra apo plantacione për fruta-perime, ferma blegtorale për qumësht, mish, vreshta, njësi përpunimi, ferma të bimëve aromatike dhe mjekësore, për turizmin rural, agroturizmin, të cilat sot punësojnë dhe zhvillojnë ekonomitë e tyre familjare, por punësojnë dhe të tjerë nëpër zona të thella rurale”, theksoi Krifca.

Ndërkohë gjatë kësaj jave ministria Krifca ishte pjesë e delegacionit zyrtar të Kryeministrit Rama, në takim me kancelarin Scholz, në Berlin.

“Ndoqa me shumë kënaqësi konfirmimin dhe mbështetjen e plotë të kancelarit ndaj Shqipërisë në rrugën e integritimit Evropian, folëm për samitin e Procesit të Berlinit, i cili do të mbahet në Tiranë, ku pjesë të tij do të ketë forume të biznesit për të nxitur më shumë bashkëpunim ekonomik mes Shqipërisë dhe

Gjermanisë. Ashtu sikurse jemi duke punuar dhe ne në ministri, me ministrinë e Bujqësisë së Gjermanisë, përmes një instrumenti të ri që po ngremë, një partneritet i ri institucional që do e firmosim së shpejti, i cili do të



synojë fuqizimin e dialogut bilateral mes ministrive tona, shkëmbimin e eksperiencës në fushat e bujqësisë, sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe do e shtrijmë më tej këtë bashkëpunim. Ndërkohë gjatë vizitës në Berlin, pata mundësi të shoh nga afër standin e Shqipërisë në panairin ndërkombëtar të turizmit në Berlin, ku më erdhi shumë mirë për prezantimin dinjitoz të vendit tonë në këtë panair, ku agroturizmi për herë të parë merrte pjesë si segment i rëndësishëm i ofertës turistike, i lidhur ndjeshëm me traditën, kulturën, me kulinarinë e njer-

zve tanë”, nënvizoi Krifca.

Ministria Krifca bëri të ditur se “nisëm gjatë kësaj jave në Qendrën e Transferimit të Teknologjive të Fushë-Krujës, një program këshillimi të dedikuar me 20 ferma blegtorale në rajonin e



Krujës dhe Shkodrës, për të ndihmuar posaçërisht fermerët të rrisin kapacitetet prodhuese. Ndërkohë që gjithashtu kemi firmosur udhëzuesin për aplikantë, për Skemën Kombëtare të Mbështetjes së Bujqësisë dhe përmes Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Agropikave, po marrim të gjitha masat për të qenë gati me fillimin e aplikimeve të Skemës së Mbështetjes në Bujqësi për këtë vit”.

“E gjithë trupa jonë e bujqësisë do të jetë në terren për të informuar fermerët për aplikime të suksesshme gjatë kësaj skeme”, tha Krifca.

Duararta Eli Zhulati është artizania e vetme qëndistare dhe prodhuese e veshjeve popullore në Gjirokastrë, me një eksperiencë rreth 15 vjeçare

Ky zanat e përfshiu Elin dhe saj, punëtore në repar-tin e jorgan punueseve dhe

do të merrte pjesë në një festival dhe duhet të kishte veshjen tradicionale. Ajo mori përsipër që duke kopjuar motivet dhe elementet e një kostumi tjetër, t'i qepte vëllait kostumin e tij. Ky kostum ishte pika e kthesës në karrierën e saj.

Eli u angazhua në shoqata dhe organizime të ndryshme, duke qepur dhe qenditur kostume për grupe të ndryshme, duke mësuar gra dhe vajza të tjera për këtë zanat. Hap pas hapi ajo mësoi dhe perfeksionoi më shumë teknikën dhe njohuritë, deri kur hapi punishten e saj në të cilën punon edhe sot.

Ajo vlerëson shumë që të rinjtë sot e kërkojnë dhe e duan kostumin popullor por nga ana tjetër pak ose aspak prej tyre kërkojnë të mësojnë dhe ta trashëgojnë këtë zanat. Ajo i trembet të ardhmes, ç' do t'i lëmë trashëgimi brezave që vijnë.

Është përpjekur shumë t'ja mësojë zanatin edhe vajzës së saj, por kjo e fundit ka ndjekur një tjetër rrugë në jetë.



Ajo tregon se kishte parë gratë e familjes së saj të punonin në tezgjah e në grep, të qendrisin, të qepnin por ishin të gjitha punë jashtë vëmendjes dhe dëshirave të saj si një vajzë e vogël.

Ajo shoqëronte nënën njëkohësisht pjesmarrëse në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës, kur bashkë me gra të tjera gjirokastrite plotësonin debutuesit e Festivalit me kostume.

Por puna e saj e parë erdhi shumë më vonë, kur vëllai i saj

Dita Ndërkombëtare e Gruas

Në ditën e 8 Marsit, Dita Ndërkombëtare e Gruas, gazeta “Agrobiznesi” po ndajmë me ju një kolazh me histori të sipërmarrëseve në Bujqësi mbi rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të grave dhe vajzave në zonat rurale të Shqipërisë. Ky është një moment i rëndësishëm për të reflektuar mbi situatën

sociale dhe ekonomike, sfidat dhe vështirësitë e jetës së përditshme të grave dhe vajzave për të siguruar mirëqenitë të komuniteteve rurale, sipërmarrjeve dhe familjeve të tyre. Në fokus të përpjekjeve të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar mbeten mirëqenia dhe fuqizimi i grave dhe vajzave në zonat rurale,

duke ndërgjegjësuar dhe krijuar një solidaritet mbarëshoqëror mbi kontributin e tyre të paçmuar në bujqësi e zhvillimin rural. KASH në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, po zbaton një sërë nismash për fuqizimin e grave në zonat rurale, agroturizmit dhe artizanit.

Hysa: Mbështetja nga IPARD na dha forcë për t'u shërbyer klientëve ushqime me cilësi

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca ndau historinë e Refie Hysës

në rubrikën “njerëzit e bujqësisë”, e cila po zhvillon një pikë agroturizmi në Belsh, El-

basan.

Hysa, tregon se, programi IPARD i dha forcë për të vazhduar dhe për t'u shërbyer klientëve vetëm ushqime me cilësi.

“Agroturizmi është formula fituese me të cilën kemi vendosur të jetojmë. Punojmë familjarisht në bujtin tonë të quajtur “Xhabajka”, pranë liqenit të Belshit. Përditë zgjohemi me një pamje të mrekullueshme. Jo vetëm brezi i ri, por të gjithë që merren me bujtina dhe agroturizma duhet të gatuajnë për klinetin njësoj sikurt po gatuajnë për fëmijët e tyre, me të njëjtin përkushtim dhe dashuri”, tha Hysa.



Localgap standard për prodhimet shqiptare që mund të prodhohen dhe tregtohen në tregun vendas kundrejt një label-i të mirënjohur

Irjana Gjana - Kryetare e Grupit Teknik të Punes (National Technical Working Group) në një intervistë për

gazetën "Agrobiznesi", tregon mbi rëndësinë e adaptimit të localgap sipas së cilës prodhimet shqiptare do mund të prodhohen dhe tregtohen në tregun vendas kundrejt një label-i të mirënjohur.

Gjana thotë se, ky standard kombëtar synon të ndihmojë prodhuesit të adoptojnë praktika të mira bujqësore.

Implementimi i localgap mund të përmirësojë gjithashtu efikasitetin e menaxhimit të fermës, të zvogëlojë ekspozimin ndaj rreziqeve të sigurisë ushqimore dhe të pajtohen me legjislacionin për sigurinë

ushqimore.

Në këtë drejtim NTWG Albania vijon punën intensive për hartimin e Udhëzuesit Kombëtar për Rregulloren IFA, Disa prej kërkesave kryesore të standardit janë rivlerësuar në raport me kuadrin ligjor obligativ në Shqipëri dhe përshatjet e nevojshme janë paraqitur, atyku është parë e arsyeshme. Pas finalizimit të draftit të Udhëzuesit Kombëtar për Rregulloren IFA, pritet të ndiqet procedura e miratimit pranë Sekretariatit Global G.A.P.



Cila është qasja LABEL?

LABEL është një program vullnetar, që do të thotë që prodhuesit, importuesit dhe shitësit me pakicë mund të aplikojnë për etiketa për produktet e tyre.

Zakonisht cikli jetësor i një produkti fillon me nxjerrjen ose kultivimin e lëndëve të para të tilla si pambuku (për tekstilet) ose druri (për produktet e letrës). Kur produkti hidhet ose riciklohet, ai vazhdon në prodhim dhe paketim, shpërndarje, përdorim dhe së fundmi në fazën e "ciklit jetësor".

Kur zhvillohen kriteret LABEL për produktet, fokusi përqendrohet në fazat ku produkti ka ndikimin më të lartë në mjedis, dhe kjo ndryshon nga produkti në produkt.

Për shembull, kur shikoni tekstilet, pëlhurat kanë ndikime të forta mjedisore kur ato lyhen, shtypen dhe zbardhen. Për këtë arsye, ekspertët hartojnë kriteret për tekstilet për të siguruar që dëmtimi gjatë prodhimit të zvogëlohet sa më shumë që të jetë e mundur. Për produktet e tjera të tilla si detergjentët, substancat që hyjnë në

produkte janë një nga fushat kryesore me përparësi. Produktet e tjera, të tilla si pajisjet elektronike, kanë një ndikim shumë të lartë mjedisor në fazat e përdorimit të tyre, kështu që kriteret do të përqendrohen në efikasitetin e konsumit të tyre të energjisë.

Mijëra produkte dhe shërbime, nga detergjentët tek produktet e tekstilit për fëmijë, kanë çertifikimin LABEL. Në këtë kuptim, LABEL është një etiketë e besueshme që identifikon produktet qasja unike e LABEL do të thotë;

- Etiketat janë verifikuar nga ekspertë të pavarur
- Kriteret ambicioze për dhjetra kategori të ndryshme të produkteve dhe shërbimeve azhurnohen rregullisht
- I gjithë cikli jetësor i produktit merret parasysh, nga prodhimi të riciklimi ose asgjësimi.
- Shëndeti i konsumatorit dhe prodhimi i përgjegjshëm është i garantuar
- Produktet përputhen me pragjet e performancës me cilësi të lartë.

INFORMACIONE

Fara alternative për një bujqësi më të qëndrueshme dhe etike!

globale. Prandaj, shumica e fermerëve nuk zotërojnë farat që mbjellin, por vetëm të drejtat për t'i përdorur ato. Në praktikë është sikur farat janë marrë me qira.

Nga pikëpamja praktike, kjo situatë krijon më shumë se disa probleme: gjigantët bujqësorë janë kompani, objektivi i të cilave është të maksimizojnë fitimin dhe jo çështjet sociale si biodiversiteti, lufta kundër urisë apo mbrojtja e fermerëve të vegjël.

Për këtë arsye, duke filluar nga viti 2012, një ekip ekspertësh të bioinxhinierisë dhe bujqësisë së qëndrueshme krijuan OSSSI – Open Source Seed Initiative, e cila synon

të zhvillojë fara alternative ndaj atyre të grupeve të mëd-



se 50 prodhues amerikanë të farave i janë bashkuar nismës, të afta të lulëzojnë në kushtet specifike klimatike dhe mjedisore të pjesëve të ndryshme të vendit. Puna e tyre mbrohet ligjërisht nga organizata, në mënyrë që të shmangen përvetësimet e papërshtatshme nga subjektet private.

Por me burim të hapur ose open source nuk do të thotë “falas”: prodhuesit e farës paguhen duke u shitur farat e tyre fermerëve, të cilët megjithatë në këtë rast fitojnë të drejtën të përdorin farat dhe derivatet sipas dëshirës. Gjithashtu, mundësisht, për t'i përmirësuar ato me përzgjedhje të tjera dhe kalime të tjera. Ashtu si me softuerin me burim të hapur

të specializuar në përzgjedhjen e varieteteve të bimëve

(open source software).

Po sepse ndryshe nga farat e prodhuara nga grupe të mëdha industriale, të cilat në shumë raste i japin jetë frutave sterile në mënyrë që të detyrojnë fermerët të blejnë farat çdo vit, **farat me burim të hapur janë pjellore.** Një pjesë e të korrave më pas mund të lihet mënjane dhe të përdoret për mbjelljen e viti të ardhshëm, ashtu siç bëjnë gjyshërit tanë.

Me pak fjalë, **farat me burim të hapur duket se janë të destinuara të japin një kontribut në biodiversitetin dhe bujqësinë e qëndrueshme:** kjo është arsyeja pse organizata të ndryshme jofitimprurëse po shfaqen në të gjitha kontinentet, objektivi i të cilave është të zhvillojnë dhe shpërndajnë fara të papatentuara dhe me cilësi shumë të lartë.

Jo-ekspertët ndoshta nuk e dinë këtë, por pothuajse të gjitha farat e përdorura zakonisht në bujqësi mbrohen nga një ose më shumë patenta. Të drejtat mbahen nga një pjesë e vogël shumëkombëshe kimike si Monsanto (grupi Bayer), Corteva (grupi DuPont), ChemChina (grupi Syngenta) të cilat me kalimin e viteve kanë zhvilluar fara që janë më rezistente ndaj sëmundjeve, me produktivitet më të lartë ose që të lulëzojnë madje në kushte më pak se ideale klimatike.

Këto fara, nga një këndvështrim i caktuar, janë të krahasueshme me sistemet operative të kompjuterëve dhe smartfonëve, të kontrolluar nga 2 ose 3 kompani të mëdha si Apple, Microsoft dhe Google. **Farat janë një biznes kolosal që vlen më shumë se 60 miliardë dollarë në shkallë**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka në fokus të veçantë zgjerimin e tregjeve të reja për eksportin e vajit të ullirit, ndërkohë që mbështet edhe nismat private në këtë drejtim.

Ministrja Frida Krifca ndau në rrjetet sociale shembullin frymëzues të Buran Malasit nga Syzezi, Berat, që ka ngritur fabrikën e përpunimit të ullirit sipas standardeve më të mira dhe eksporton vaj ulliri ekstra të virgjër në Amerikë, Malin e Zi, Gjermani dhe Itali.

Drejtuësit e kësaj sipërmarrjeje të rëndësishme për gjithë fermerët e zonës, prej vitesh janë përqendruar në përmirësimin e teknologjisë së përpunimit, mbështetur edhe përmes programeve të ofruara nga MBZHR, duke prodhuar vaj ulliri cilësor e me standarde, konkurrues jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për tregun ndërkombëtar.



Buran Malasi, përfaqësues i kompanisë “Malasi Olive Oil”, tregon se prej vitit '98 është angazhuar me prodhimin e ullinjve dhe më pas ai zgjeroni biznesin edhe në ngritjen e

fabrikës së re të përpunimit të ullirit dhe prodhimin e vajit të ullirit.

Ai e konsideron këtë vit si vitin më të mirë dhe të mbarë në prodhimin e ullinjve.

“Malasi Olive Oil”, vaji i certifikuar i ullirit gjen tregje në Europë e në SHBA

“Investimin për ngritjen e fabrikës e nisëm për përpunimin e ullinjve të fshatit dhe zonës përreth, por duke parë rritjen e sasisë së prodhimit të



ullirit”, u shpreh Malasi. Burani thotë se është viti i dytë që çon vaj në Amerikë,

vajit të ullirit dhe cilësinë e tij nisëm edhe eksportin e vajit të

specie e veçantë është në listën e kuqe ndërkombëtare, që janë speciet më të rrezikuara”, theksoi Kumbaro.

Mal të Zi, Itali dhe Gjermani ndërsa ka 25 vjet që punon në këtë sektor të rëndësishëm të ekonominë bujqësore. “Vaji që eksportojmë është i certifikuar sipas standardeve më të mira”, thotë Burani.

Ndërsa Antoni Malerba, sipërmarrësi italian nga Bari, që blen vajin nga fabrika “Malasi Olive Oil”, tregon se është shumë i kënaqur për bashkëpunimin me këtë kompani që prodhon vajin e ullirit të një cilësie të lartë duke konkurruar edhe vende të tjera të Europës që shquhen për prodhimin e ullinjve dhe prodhimin e vajit.

“Vaji i ullirit që unë eksportoj nga Burani është i një cilësie superiore që ka vaji shqiptar. Kjo është ngarkesa e tretë me vaj që eksportoj në Itali, ndërsa kontratat e bashkëpunimit parashikojmë t'i shtrijmë në periudhë afatgjatë”, tha Malerba.

Limoni havjar nga Australia - Kultivohet edhe në Lushnjë, kushton 87 euro kilogrami

Parcela më e veçantë e agrumeve në Shqipëri. ndodhet në Fier Shegan të Lushnjes, Klodi Hida, ka arritur të sjellë nga Australia, limonin havjar.

“Unë kam mbjellë 4 dynym që janë rreth 270 bimë, gjithsej kam tre varietete të ndryshme. Ky limon është i vecnatë nga veteti kuruese për shëndetin e njeriut, pasi cilësohet si antibiotik i shtrenjtë”, tha Klodi Hida-fermer.

Limoni havjar nuk është i veçantë vetëm nga madhësia dhe ngjyra, por edhe nga vetëtitë e tij kuruese. Të gjithë këto e bëjnë limonin havjar më te shtrenjtin në treg, kur një kilogram kushton 87 euro.

“Tani do të presim një limon, shikoni ky nuk ka lëng. Njëri nga varietetet ka ngjyrë rozë dhe përmbajtjen e ka si vezë peshku. Shikoni dhe varietetin jeshil ku i ndryshon shija dhe ngjyra”, u shpreh Klodi Hida-fermer.

Deri para 5 vitesh, Klodi në atë tokë kultivonte grurë, fasule,

domate dhe tranguj. Por këto prodhime bujqësore i siguronin gjithnjë e më pak fitime, arsyt ekonomike e nxiten fermerin

Shqipëria është një vend i bekuar për nga klima, pasi në të mund të rrisësh dhe fruta të ndryshme për të cilat



drejt një kulture të re bujqësore, siç ishte limoni havjar.

“Ai që më ndihmoi për t'i sjellë këto bimë, më siguroi dhe tregun duke i çuar në Itali, Francë dhe Gjermani. Pasi në Shqipëri është tepër i shtrenjtë për konsumatorin vendas”, u shpreh Klodi Hida-fermer

tregu european ka qaq shumë nevojë. Këtu mund të prodhohet fruti i pasionit, goxhiberri, aronia, dhe limoni havjar. Por për tu bërë faktor të tregun ndërkombëtar fermerët si Klodi kanë nevojë për mbështetje nga Ministria e Bujqësisë

Tulipani shqiptar shpallet “monument natyre”

Qeveria shqiptare shpalli “monument natyre” një specie të veçantë që bën pjesë në speciet e rrezikuara, që quhet “Tulipani shqiptar” (Tulipa albanica).



Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro tha sot pas mbledhjes së qeverisë se, “tulipani shqiptar

është zbuluar në 2003 nga shkencëtarët e biodiversitetit dhe të biologjisë”.

“Tulipani shqiptar rritet në një lëndinë të caktuar prej 35 ha në fshatin Surroj në bash-

kinë e Kukësit. Me shpalljen “monument natyre”, kjo zonë merr këtë tipologji mbrojtje. Duhet të theksojmë që kjo

specie e veçantë është në listën e kuqe ndërkombëtare, që janë speciet më të rrezikuara”, theksoi Kumbaro.

“Tulipa albanica” është një lloj tulipani endemik që rritet vetëm në Republikën e Shqipërisë, në qarkun e Kukësit.

Tulipani shqiptar ngjan me tulipanin e Sardenjës “Tulipa scardica” dhe me “Tulipa schrenkii”, por dallon nga to pasi ka gjethe me valëzim si dhe është i ndryshëm nga ana gjenetike.

Zbuluesit e kësaj specie janë prof. as. dr. Lulëzim Shuka, pedagog i Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, në bashkëpunim me prof. Kit Tan, pedagogje në Institutin e Biologjisë në Universitetin e Kopenhagenit, Danimarkë.

Në botë deri tani njiheshin rreth 113 lloje tulipanësh, ndërsa tulipani i Kukësit renditet i 114.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



**MBËSHTETJE FINANCIARE
PËR TË GJITHË FERMERËT**

**KREDI E DEDIKUAR
PËR MBJELLJEN E GRURIT**



KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

KËSHILLA PËR FERMERËT MBI SHËRBIMET NË KULTURAT DRUFROTORE

Muaji janar dhe shkurt janë periudha optimale për krasitjen e pemëve frutore. Kjo është e lidhur me procesin e trajtimeve dimërore kundër fazave dimëruese të sëmundjeve dhe dëmtuesve të pemëve. Në zonën e ulët bregdetare muaji janar përbën kohën më optimal nisur nga temperaturat e motit të cilat pësojnë ngritje dhe detyrojnë pemën të zgjohet. Ndërsa për zonat veri lindore krasitja bëhet gjatë muajit shkurt, duke i shpëtuar uljeve të mëdha të temperaturave të motit.

Procesi i krasitjes kryhet gjatë fazës së qetësisë dimërore të pemëve, duke filluar prej rënies së gjetheve në vjeshtë dhe deri në fillim të lëvizjes së lëngjeve në pranverë. Pemët bërthamore është mirë të krasiten në muajt Janar dhe Shkurt sipas zonave klimatike, sepse janë më të ndjeshme ndaj temperaturave të ulëta. Para fillimit të krasitjes është e domosdoshme të studjohet pema mirë, të vërehen të gjitha degët si dhe raporti i degëzave prodhuese dhe atyre vegetative. Nga gjendja aktuale do të varet intensiteti i krasitjes së masës drunore që duhet eliminuar. Gjithashtu që në fillim duhet përcaktuar për formën e kurorës, ku krasitja ti përshtatet kurorës së dëshiruar, me formim të degëve skeletore të nevojshme, atyre të rendit të dytë, formim të rregullt të vazhduesit, eliminim të thithakëve etj. Me krasitje duhet të eliminohen degëzat e infektuara me sëmundje të ndryshme kancerogjene, ato të dëmtuara dhe të thyera, të mbahet një kurorë e ajrosur mirë sepse mundësia e mbrojtjes nga sëmundje dhe dëmtues është më e madhe. Degëzat në hije ku ka intensitet të vogël të fotosintezës nuk formojnë sytha frutorë. Thithakët konsumojnë sasi të madhe të lëndëve ushqyese, formohen më tepër në degëza skel-

etore, hijezojnë shumë kurorën dhe nuk formojnë sytha frutorë andaj me krasitje duhet eliminuar.

Krasitësi duhet të ketë parasysh:

- Të bëjë përzgjedhje të formës kurorës;
- Të bëjë përzgjedhje të drejtë të degëve skeletore dhe të vazhduesit;
- Të eliminohen të gjithë thithakët;
- Të eliminohen degët e thyera, nëse ka;
- Të eliminohen degët e infektuara nga sëmundje dhe plagë kancerogjene;
- Gjithashtu duhet eliminuar degëzat e orientuara në brëndësi të kurorës ose të kryqëzuara.

Krasitja nuk mund të realizohet pa i ndërlikuar njohurit teorike me përvojën praktike, prandaj krasitësi duhet të ketë përvojë dhe vëmendjen e duhur sepse krasitja nuk nënkupton vetëm prerje të degëve dhe degëzave të pemës, por është proces mjaft i ndërlikuar nga i cili varet jetëgjatësia dhe produktiviteti i pemës. Prandaj në këtë proces duhet ta kryejnë puntorë të specializuar të cilët kanë njohuri dhe përkushtim në kultivimin e pemëve frutore. Nëpërmjet procesit të krasitjes duhet të realizohen



këto qëllime:

- Formim i drejtë i kurorës së caktuar;
- Prodhimtari e rregullt;
- Cilësi e lartë e frutave;
- Jetëgjatësi e pemës
- Sa më pak dëmtime nga sëmundje dhe dëmtues të pemëve

Krasitja e pemëve frutore është një nga masat më të rëndësishme agroteknike, që ka për qëllim formim të rregullt të kurorës, hyrje sa me të shpejtë në prodhim, cilësi të lartë të fruitit si dhe jetë sa ma të gjatë e të shëndetshme të pemëve frutore.

Pas krasitjes duhet të bëhen trajtime dimërore me lëng bordoles 3%

Mbrotja e bimëve

Në pemëtari - Mbas procesit të krasitjes dhe largimit të djegies të degëve të krasitura do të merren masa për fillimin e trajtimeve dimërore, kundër fazave dimëruese të sëmundjeve dhe dëmtuesve. Të kryhet një trajtim me preparate me bazë bakri si Pastë bordolezi 20% me dozën 1% + vajra mineralë të bardhë me dozën 0.3% ose një trajtim me lëng bordolezi 2-3% e



Drejtorja e Teknologjive të Pemëtarisë: QTTB-Vlorë
E-mail: qttbvlore@yahoo.com

pas 10 ditësh të ndërhyet me trajtime të vecanta më vajra mineral të bardha me dozën 3-4%. Të bëhet dizinfektimi i të gjitha plagëve të krijuara nga procesi i krasitjes, por edhe i trungut me solucion 5-7 % pastë bordolezi. Trajtimi dimëror në pemë do të bëhet në kushte të përshtatshme, pa erë dhe shi për të rritur sa më shumë efektin e preparatit si dhe ruajtjen e punonjësve nga kontaminimet e mundëshme. Afati i përfundimit; për zonën e ulët bregdetare brënda muajit Janar dhe për zonën veri e veri-lindore brenda muajit Shkurt.

Në ullinj. Me përfundimin e korrigjimit të krasitjes të bërë gjatë procesit të vjeljes të merren masa për largimin dhe djegjen e të gjitha degëve si një masë e nevojshme që kufizon në maksimum drungrënësin e ullirit. Duke qenë se në bimë do të krijohen shumë plagë nga vjelja por edhe prerja me sopatë e sharrë motorike del e nevojshme të bëhet dizinfektimi i të gjitha plagëve me solucion 10% gurrkali ose të organizohet puna për të bërë një spërkatje me preparate me bazë bakri në të gjithë kurorën me pompë motorike.

Në vresht. Pasi të përfundojë krasitja të largohen lastarët e prerë, të lidhën, drejtohen shtyllat, shtërngohen telat mbështetës do të merren masa për spërkatjen dimërore me lëng bordolezi 2.5%, ose trajtim me pastë bordolezi 0.8%+ vajra mineral të bardhë me dozën 0.3% ku nevojiten 13 kg pastë bordolezi+ 6 litra vaj mineral të bardhë.

Në agrume. Të kryhet një spërkatje dimërore me pastë bordolezi me dozën 0.7% + vajra mineralë të bardhë kundër breshkëzave me dozën 0.3%.

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

KËSHILLA PËR FERMERËT KULTIVUES TË BIMËS SË MISRIT

Kushtet klimatike të gjysmës së dytë të muajit Shkurt duket që do të favorizojnë kryerjen e ndërhyrjeve të mëposhteme, për ato fermerë që për arsye të ndryshme nuk kanë mundur t'i realizojnë me herët gjatë muajve Dhjetor apo Janar.

1. Sigurimin dhe mbajtjen në efikasitet të sistemit kullues të brendëshëm dhe të jashtëm për parcelat e planifikuara për t'u mbjellë me misër.

Përmes kësaj mase agroteknike mundsohet lehtësi në punimet përgatitore në pranverë dhe hershmëri në mbjellje.

2. Plugim i tokave të planifikuara për

t'u mbjellë me misër.

Sipas mundësive mund të vazhdohet plugimi i tokave të planifikuara për t'u mbjellje me misër në të gjithë vendin, veçanërisht për zonat malore dhe kodrinore. Para plugimit rekomandohet shpërndarje të plehut organik sipas mundësive të fermerit.

Kjo ndërhyrje ndikon pozitivisht në

reduktimin e punimeve përgatitore në pranverë, pasurimin e tokës, konservim të ujërave në shtresat e poshtëme, shkatërrim të rezervave dimëruese të dëmtuesve apo sëmundjeve të ndryshme që atakojnë bimën e misrit.

3. Në Ultërsirën Perëndimore, për tokat e zëna me kultura të dyta si bazë ush-

qimore e njome për blektorinë dhe që planifikohen për t'u mbjellë me misër, të intensifikohen shërbimet (pleherimet plotësuese) për të arritur marrjen e prodhimit dhe lirimin e parcelave në kohë të përshtatshme për mbjellje me misër.

4. Fermerët nëpërmjet njësive të Shërbimit Këshillimor (SEB-ve) të fillojnë konsultimet mbi përzgjedhjen e hibrideve me të mirë dhe të përshtatshëm për zonën dhe kushtet e kultivimit sipas destinacionit të konsumit (kokërr apo silazh).

Per informacione të metejshme mund të kontaktoni ne:
Cel: +355 68 42 982 98; E-mail: rexhaarsen@yahoo.com

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

KËSHILLA MBI SHËRBIMET E STINËS NË FRUTIKULTURË

Periodha e pranverës është një periudhë e ngjeshur me punë në sektorin e frutikulturës. Është moment i një pune intensive. Shërbimet kryesore gjatë kësaj periudhe janë:

1. Plehërimet. Tek drufrutorët vërehen dy periudha të asimilimit intensiv të lëndëve ushqyese herët në pranverë (çelja e sythave, lulëzimi formimi i aparatit gjethor).

Në vjeshtë, pas frenimit të rritjes dhe vjeljes së frutave, që lidhet me rritjen e rrënjëve dhe krijimin e sythave frutore.

Në pranverë nga plehurat fosfatike: duhet të shpërndahet gjysma e sasisë vjetore. Fosfori ka efekt stimulues për fillimin e vegjetacionit dhe ndikon pozitivisht mbi rritjen e zhvillimit të aparatit rrënjor.

Plehurat azotike deri në fillimin e lulëzimit pemët frutore përdorin për nevojat e tyre me azot rezervat që ato kanë grumbulluar vitin e mëparshëm. Mbas kësaj faze duhet të shpërndahet 40% -50% të nevojave vjetore të bimëve për këtë element mbasi ajo duhet të përballojë konsumin e madh që kërkon rritja e vegjetacionit të ri.

Sasia e plehrave kimike duhet të jetë e kontrolluar në varësi të moshës së pemëtoreve. Në pemëtoret e reja sasia e plehurat duhet të jetë deri në 0.5 kg për rrënjë dhe në pemëtoret në prodhim 1-2 kg për rrënjë.

2. Përmbytja e plehurat nëpërmjet punimit nën kurorë, në këtë moment duhet të kihet parasysh mbulimi i gjithë sasisë së plehurat të hedhur para punimit.

3. Plugimi midis rreshtit me traktor. Punimi i sipërfaqes midis rreshtit si dhe punimi i bimëve nën kurorë mbajnë të gjithë sipërfaqen e mbjellë, të pastër nga barërat e këqija dhe ulin rrezikun e infeksionit nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

4. Mbrojtja e bimëve. Sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm shkaktojnë dëme të konsiderueshme si nga pikëpamja cilësore ashtu edhe sasiore. Nisur nga kjo është e domosdoshme ndërmarrja e masave të kontrollit të integruar dhe në të njëjtën kohë, implementimi i paketave të menaxhimit të integruar. Kjo përbën një ndër kushtet kryesore për minimizimin e dëmit të shkakuar nga këta parazitë dhe

gjithashtu ndikon ndjeshëm në uljen e kostos së nevojshme të kontrollit të parazitëve, e për rrjedhojë në rritjen e të ardhurave nga ana e fermerëve.

Vreshti

Vrugu i hardhisë (Plasmopara viticola) Është një ndër sëmundjet më të rrezikshme për kulturën e hardhisë dhe mund të shkaktojë dëme shumë të mëdha, të cilat mund të arrijnë në dëmtim të 80-100 % të prodhimit, përveç kësaj sjell pasoja edhe për prodhimin e vitit pasardhës.

Shenjat e para të vrugut i gjejmë në gjethë, zakonisht nga fundi i Prillit fillimi i Majit. Në gjethë formohen disa njolla të quajtura njolla vaji. Njollat janë të shndritshme në fillim, me ngjyrë të gjelbër të zbehtë, ndërsa më vonë marrin ngjyrë kafe.

Në degë: Infektimi kufizohet sidomos në nyjet dhe në indin parenhimatik. Zakonisht lastarët që janë prekur rëndë nga vrugu, janë më të thyeshëm, nuk drunjëzohen dhe për pasojë nuk piqen, kështu që thahen menjëherë në ngricat e dimrit.

Në lule

Mund të preken para se të çelin, dhe në këtë rast mbulesa e tyre merr ngjyrë të zezë dhe thahen. Lule të tilla rrëzohen menjëherë në tokë.

Në fazën e celjes së sythave është e domosdoshme të bëhet një spërkatje me Ovipron Top me dozën 1,5 % + bordolez ose champion në dozat 0.5 %.

Hiri i hardhisë - (Uncinula necator)

Përhapja dhe dëmi:

Hiri është një ndër sëmundjet më të rrezikshme të hardhisë. Në vite të favorshme për të, mund të dëmtojë prodhimin në masën mbi 50-80 %, përveç cilësisë së rrushit i cili shpesh del jashtë përdorimit.

Sëmundja për herë të parë u zbulua nga Tuckeri në vitin 1845, në periferi të Londrës, ndërsa në vitin 1847, ishte Berkeley

i pari që studjoi dhe shkroi për karakteristikat dhe rrezikun e kësaj sëmundjeje. Brenda pak vitesh, sëmundja u përhap jo vetëm në pellgun e Mesdheut, por edhe në Azi, Afrikë dhe Australi.

Hiri prek dhe dëmton të gjitha organet jo drunore (pjesët e gjelbërta) të hardhisë si: gjethet, lastarët dhe kokrrat në sipërfaqe të tyre, pa qenë nevoja të hyjë brenda në to, që do të thotë se zhvillohet si ektoparazit.

Si të gjitha Erysiphacet edhe hiri i hardhisë shfaqet në të gjitha pjesët e gjelbërta të hardhisë.

Ndeshet në pranverë, në lastarët e rinj të gjelbër, më vonë në gjethet e zhvilluara dhe së fundi në kokrrat e rrushit.

Ulliri

Tenja - (Prays oleellus F.)

Mënyra e jetesës

Nga vezët që vendos insekti në Shtator-Tetor lindin larvat e breznisë së parë, të cilat shpojnë epidermën e anës së poshtme të gjethëve dhe hyjnë në mezofil (zakonisht nga një larvë për çdo gjethë). Në muajt Janar- Shkurt larva del jashtë, bën një galeri tjetër më të gjerë 4-5 mm në të njëjtën gjethë ose në një gjethë tjetër. Në fillim të Marsit larva del prej galerisë dhe qendron në anën e poshtme të gjethës. Dalja e tenjave të breznisë së parë vihet re gjatë muajit Prill. Gjatë ditës ato qendrojnë në anën e poshtme të gjethëve të ullirit dhe fluturojnë në mbrëmje dhe natën. Mbas pak ditësh kopulohen dhe pastaj femrat e fekunduara i vendosin vezët në kurorën e gonxheve të luleve. Një femër mund të vendosë rreth 300-500 vezë. Larvat e breznisë së dytë hyjnë në gonxhet e mbyllura dhe brejnë pjalmoret dhe stilet duke kaluar nga një gonxhe në tjetrën.

Kur gonxhet janë të hapura i brejnë nga jashtë dhe i bashkojnë me lulet dhe gonxhet me fije të mëndafshta.

Një larvë mund të dëmtojë 10-20 lule

Luftimi i tenjës realizohet duke bërë një

trajtim me preparatin Nurelle D me dozën 0.12 % në fillim të fazës së lulëzimit

Syri i palloit - (Cycloconium oleaginum Cast)

Njollat e para formohen në anën e sipërme të gjethës në formë koncentrike me ngjyrë kafe të gjelbër që mbas një kohe merr ngjyrë më të errët. Në një gjethë mund të gjenden sipas shkallës së infeksionit 1-25 njolla, që formojnë një myk me ngjyrë hiri, i cili nuk pastrohet mbasi është futur në kutikulën e gjethës.

Kur njollat arrijnë zhvillimin e plotë, diametri i tyre arrin 10-12 mm. Gjatë muajve të nxehtë njollat rrethohen nga një unazë me ngjyrë të verdhë, e cila i përngjet syrit të palloit nga ka marrë edhe emrin sëmundja.. Gjethet e prekura rrëzohen para kohe në tokë.

Përhapja e sëmundjes bëhet nëpërmjet konideve me anën e ujit të shiut.

Kontrolli i sëmundjes. Është moment i duhur për të ndërhyr me një spërkatje me preparatin Syllit 400 SC me dozën 0.2%. ose Bordolez me dozën 0.7% Trajtimet duhen bërë me pompa motorike që sigurojnë presione të larta atmosferike. Cilësia e spërkatjes është vendimtare në kontrollin e kësaj sëmundjeje.

Pjeshka

Në fazën e fryrjes së sythave rekomandohet të bëhet një trajtim me preparatin Bordoles 0.6 %. Në momentin kur sythat të marrin ngjyrë rozë duhet të ndërhyet me një spërkatje me preparatin Syllit 400 SC me dozën 0,2%.

Agrumet

Me fillimin e ngritjes së temperaturave dhe avancimit të celjeve të reja krijohen kushte të favorshme për shpërthimin e kolonive të afideve, prandaj fermerët duhet të monitorojnë vazhdimisht agrumishtet dhe me konstatimin e kolonive të para të ndërhyet menjëherë me trajtimet kimike duke përdorur Movento me dozën 0.15% ose Confidor me dozën 0.05 %.

Për të parandaluar dhe izoluar përhapjen e meteishme të kalbëzimeve është e nevojshme që nga fundi i muajit Mars dhe fillimi i Prillit të ndërhyet duke bërë një spërkatje me preparatin Aliete me dozën 0.3%

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

KËSHILLAT E EKSPERTIT

INFORMACION PËR FERMERËT QË KULTUOJNË BIMË AROMATIKE MEDICINALE (BAM), Mars 2022

1. Shërbime intensive në farishte (ujtje, ushqim, plehrime plotësuese, ajrim, luftim sëmundjesh etj.)

2. Mbjellje e farishteve të reja me copa, (me ndarje të bimëve të rritura).

3. Fillimi i aklimatizimit të fidanit (përshatja me kushtet klimatike).

4. Punimi i zakonshëm i tokave të pluguara që në vjeshtë (21-25 cm).

5. Diskimë, frezim i tokave.

6. Piketime parcelash.

7. Mbjellje e fidanave në fushë.

8. Pastrim gurësh i parcelave të mbjella dhe

atyre të pambjella.

9. Sistemime, pastrime, eliminime i mbeturinave.

10. Kultivime dhe (frezime, aty ku e lejojnë distancat e mbjelljes) të Bimëve Aromatike Medicinale (BAM).

11. Plehërimet plotësuese aty ku janë planifikuar të bëhen për prodhim konvencional.

12. Zëvendësim i bimëve të dëmtuara gjatë dimrit.

Drejtorja e Teknologjive Bujqësore, QTTB-Shkodër,
E-mail: qttbshkoder@yahoo.com

Drejtorja e Teknologjive të Pemëtarisë: QTTB-Vlorë
E-mail: qttbvlore@yahoo.com

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000



